

Forma juridike: Shoqëri me Pëgjegjesi të Kufizuar

Data e themelimit: 26 Prill 1995

Numri unik i indentifikimit (NIPT): J 62305002 A

Selia: Rruga "Qemal Stafa" Pall.132, Tirane

Objekti tregtar: Shërbime projektimi, supervizioni dhe konsulence

Pasqyrat Financiare Vjetore **2014**

(Mbyllur më 31.12.2014)

Pasqyra financiare: Individuale (jokonsoliduara)

Periudha kontabel: Nga 01.01.2014 deri më 31.12.2014

Data e mbylljes: 18 Shkurt 2015

Monedha: Leke

Shkalla e rrumbullakimit: ne leke

Tiranë, Shkurt 2015

Tabela e përmbajtjes

| | |
|---------------------------------------------------|------|
| A. RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR..... | 0 |
| B. BILANCI KONTABEL | 2 |
| C. PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE | 3 |
| D. PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE | 4 |
| E. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALET E VETA..... | 5 |
| F. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE | 6-11 |

Raport i Audituesit të Pavarur

Për Ortakët e shoqërisë "INFRATRANSPROJEKT" sh.p.k
Adresa selise: Rruga "Qemal Atafa" Nr.32, Tiranë.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkangjitur të shoqërisë "InfraTransProjekt" sh.p.k, të cilat përfshijnë bilancin kontabel të datës 31 Dhjetor 2014 dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e fluksit të parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin mbyllur në këtë datë, një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël, si dhe informacionin tjetër shpjegues.

Përgjegjësia e drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Shqipëtare të Raportimit Financiar (SKK-të), dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurine e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale. Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithëshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatëshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyre të drejtë, pozicionin financiar të shoqërisë "InfraTransProjekt" sh.p.k, më datën 31 Dhjetor 2014, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur, në përputhje me Standartet Shqipëtare të Raportimit Financiar(SKK-të).

Ekspert Kontabel i Regjistruar

Dhimo Dundo

Tiranë, më 10 Shkurt 2015



Bilanci kontabël
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
(Të gjitha balancat janë në lekë)

| | Shënime | Viti raportues 31.12.2014 | Viti paraardhës 31.12.2013 |
|---------------------------------------------------|---------|------------------------------|-------------------------------|
| A AKTIVET | | | |
| I Aktive Afatshkurtera | | | |
| Aktive monetare | 3 | 86,193,901 | 75,415,136 |
| Derivativë dhe aktive të mbajtura për tregtim | | - | - |
| Aktive të tjera financiare afatshkurtra | 4 | 35,445,731 | 33,482,723 |
| Inventari | | - | - |
| Aktivët afatshkurtra të mbajtura për shitje | | - | - |
| Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra | | - | - |
| Totali i Aktiveve Afatshkurtera(I) | | 121,639,632 | 108,897,859 |
| II Aktive Afatgjata | | | |
| Investimet financiare afatgjata | | - | - |
| Aktive afatgjata materiale | 5 | 3,831,017 | 4,295,737 |
| Aktivët afatgjata jomateriale | | - | - |
| Kapital aksionar i papaguar | | - | - |
| Aktive të tjera afatgjata | | - | - |
| Totali i Aktiveve Afatgjata(II) | | 3,831,017 | 4,295,737 |
| TOTALI I AKTIVEVE (I + II) | | 125,470,649 | 113,193,596 |
| B DETYRIMET DHE KAPITALI | | | |
| I Detyrime Afatshkurtera | | | |
| Huamarrjet | | - | - |
| Huatë dhe parapagimet | 6 | 1,886,399 | 2,251,067 |
| Grantet dhe të ardhurat e shtyra | | - | - |
| Provizionet afatshkurtra | | - | - |
| Totali i Detyrimeve Afatshkurtera (I) | | 1,886,399 | 2,251,067 |
| II Detyrime Afatgjata | | | |
| Huatë afatgjata | | - | - |
| Huamarrje të tjera afatgjata | | - | - |
| Provizionet afatgjata | | - | - |
| Grantet dhe të ardhurat e shtyra | | - | - |
| Totali i Detyrimeve Afatgjata (II) | | - | - |
| Totali i Detyrimeve (I+II) | | 1,886,399 | 2,251,067 |
| III Kapitali | | | |
| Kapitali i regjistruar (aksionar) | 7 | 110,000 | 110,000 |
| Primi i aksionit | | - | - |
| Njësitë ose aksionet e thesarit (negative) | | - | - |
| Rezerva statutore | | - | - |
| Rezerva ligjore | 7 | - | - |
| Rezerva të tjera | 7 | 38,029,265 | 38,029,265 |
| Fitimet(humbja) te pashpërndara | | 57,803,264 | 43,971,738 |
| Fitimi (humbja) e vitit financiar | 8 | 27,641,721 | 28,831,526 |
| Totali i Kapitalit (III) | | 123,584,250 | 110,942,529 |
| TOTALI I DETYRIMEVE E KAPITALIT (I,II,III) | | 125,470,649 | 113,193,596 |

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
(Të gjitha balancat janë në lekë)

| Përshkrimi i Elementëve | Shënime | Viti raportues 31.12.2014 | Viti paraardhës 31.12.2013 |
|----------------------------------------------------------------------------------------|----------|------------------------------|-------------------------------|
| 1 Shitjet neto | 8 | 64,329,973 | 55,140,212 |
| 2 Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit(Pu | . | - | - |
| 3 Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dl | . | - | - |
| 4 Materialet dhe mallrat e konsumuara | 8 | (1,017,919) | (1,076,923) |
| 5 Kosto e punës | 8 | | |
| Pagat e personelit | | (6,683,000) | (9,125,228) |
| Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore | | (1,094,717) | (1,140,150) |
| 6 Amortizimet dhe zhvlerësimet | | (910,499) | (1,057,199) |
| 7 Shpenzime të tjera | | (21,995,549) | (10,220,713) |
| 8 Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7) | | (31,701,684) | (22,620,213) |
| 9 Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+3-8) | 1 | 32,628,289 | 32,519,999 |
| 10 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara | | - | - |
| 11 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet | | - | - |
| 12 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare | 8 | - | - |
| 12.1 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata | | - | - |
| 12.2 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat 767, 667 | | - | - |
| 12.3 Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi 769, 669 | | 61,460 | (498,908) |
| 12.4 Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668 | | 21,922 | 148,520 |
| 13 Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare | | 83,382 | (350,388) |
| 14 Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13) | 1 | 32,711,671 | 32,169,611 |
| 15 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 69 | 9 | 5,069,950 | 3,338,085 |
| 16 Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15) | 8 | 27,641,721 | 28,831,526 |
| 17 Elementët e pasqyrave të konsoliduara | | - | - |

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e rrjedhjes së parasë(cash flow)
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
(Të gjitha balancat janë në lekë)

| Pasqyra e fluksit monetar – Metoda indrekte | Shenime | Viti raportues 31.12.2014 | Viti paraardhës 31.12.2013 |
|----------------------------------------------------------------------|---------|------------------------------|-------------------------------|
| Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit | | | |
| Fitimi para tatimit | | 32,711,671 | 32,169,611 |
| Rregullime për: | | | |
| Amortizimin | | 910,499 | 1,057,199 |
| Humbje nga këmbimet valutore | | - | - |
| Të ardhura nga investimet(Rezultati shitje AAM-ve) | | - | - |
| Shpenzime për interesa | | - | - |
| Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktivi | | (1,337,929) | (11,692,020) |
| Rritje/rënie në tepricën inventarit | | - | - |
| Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti | | (364,668) | 595,965 |
| Mjete monetare të përfituara nga aktivitetet | | 31,919,573 | 22,130,755 |
| Interesi i paguar | | - | - |
| Tatim mbi fitimin i paguar | | (5,695,029) | (2,780,289) |
| Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit | | 26,224,544 | 19,350,466 |
| Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese | | | |
| Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara | | - | - |
| Blerja e aktiveve afatgjata materiale | | (445,779) | (164,817) |
| Të ardhura nga shitja e pajisjeve | | - | - |
| Interesi i arkëtuar | | - | - |
| Dividendët e arkëtuar | | - | - |
| Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese | | (445,779) | (164,817) |
| Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare | | | |
| Hyrje nga emetimi i kapitalit aksioner | | - | - |
| Hyrje nga huamarrje afatgjata | | - | - |
| Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare | | - | - |
| Dividendët e paguar | | (15,000,000) | - |
| Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare | | (15,000,000) | - |
| Rritja/rënia neto e mjeteve monetare | | 10,778,765 | 19,185,649 |
| Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël | | 75,415,136 | 56,229,487 |
| Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël | | 86,193,901 | 75,415,136 |

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
(Të gjitha balancat janë në lekë)

| | Kapitali i regjistruar(ak sionar) | Primi i aksionit | Rezerva ligjore statusore | Fitimi pashpërndarë | Totali |
|---------------------------------------|-----------------------------------|------------------|---------------------------|---------------------|--------------|
| Pozicioni më 31 Dhjetor 2012 | 110,000 | - | 53,124,865 | 28,876,138 | 82,111,003 |
| Efekt ndryshimeve ne politikat kontal | - | - | - | - | - |
| Pozicioni i rregulluar | 110,000 | - | 53,124,865 | 28,876,138 | 82,111,003 |
| Fitimi neto për periudhën kontabël | | | | 28,831,526 | 28,831,526 |
| Dividentët e paguar | | | | - | - |
| Rritje e rezervës së kapitalit | - | | 28,876,138 | (28,876,138) | - |
| Emetimi i kuotave(aksioneve) | - | - | | | - |
| Pozicioni më 31 Dhjetor 2013 | 110,000 | - | 82,001,003 | 28,831,526 | 110,942,529 |
| Fitimi neto për periudhën kontabël | - | - | | 27,641,721 | 27,641,721 |
| Dividentët e paguar | - | - | | (15,000,000) | (15,000,000) |
| Emetim i kapitalit aksionar | - | - | | | - |
| Rritje e rezervës së kapitalit | | | 13,831,526 | (13,831,526) | - |
| Aksione te thesarit te riblera | - | - | - | - | - |
| Pozicioni më 31 Dhjetor 2014 | 110,000 | - | 95,832,529 | 27,641,721 | 123,584,250 |

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i "InfraTransProject" sh.p.k dhe janë firmosur nga:

Administratori

Faruk KABA



Harteri
Aljona Bulica

Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
(Të gjitha balancat janë në lekë)

1. Informacione te pergjitheshme

"InfraTransProject" sh.p.k, eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me 26 Prill 1995 dhe eshte e indentifikuar me NIPT-in-J62305002A. Kapitali rregjistruar i saj aktualisht eshte 110.000 leke dhe zotrohet nga ortaket, z.Faruk Kaba dhe znj.Teuta Kaba.

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2014 jane sherbimet ne fushen e projektimit,supervizionit dhe konsulences ingjinerike.

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar 'Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare' dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-te). Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te koston historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te drejtave te kostatuara. Paraqitja e tyre eshte bere ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ("lekë).

Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqeria, janë si më poshtë:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përloganitet me besueshmëri.Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci,zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e koston historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2014 jane 1 euro=140.14 leke dhe 1 dollar= 115.23 leke

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor.Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2014 eshte 15 % nga 10% qe ishte ne ushtrimin e mëparshëm.

Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u

arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivitet e afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale(AAM-të) bazohen ne modelin e koston historike. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Në se vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazen e metodes se vleres se mbetur dhe normat e perdorura jane ne ndertesa 5 % dhe per aktivet e tjera 20% te vleres se mbetur.

Gjendjet e inventaret

Vlerësimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimit qe nga drejtimi është çmuar si vlera neto te realizueshme.

3. Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne fillim dhe fund te ushtrimit 2014 jane si me poshte:

| Emertimi i Llogarise | Monedha | Gjendja ne 31.12.2014 | | Gjendja ne 31.12.2013 | |
|----------------------|---------|-----------------------|-----------|-----------------------|-----------|
| | | Ne leke | Ne valute | Ne leke | Ne valute |
| Llogari bankare | LEK | 64,599,179 | - | 54,241,899 | - |
| Arka ne leke | LEK | 21,594,722 | 0 | 21,173,237 | - |
| Shuma | | 86,193,901 | x | 75,415,136 | x |

Gjendjet e llogarive te likuiditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit te ushtrimit te bankes respektive.

4. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2013 deklarohen si vijon:

| | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014 | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013 |
|------------------------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|
| Aktive të tjera financiare afatshkurtra | | |
| (i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme | 2,888,665 | 5,665,954 |
| (ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme | 12,554,696 | 10,146,129 |
| (iii) Instrumente të tjera borxhi | 20,002,370 | 17,670,640 |
| (iv) Investime të tjera financiare | 0 | 0 |
| Shuma | 35,445,731 | 33,482,723 |

Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme " jane pasqyruar kerkesat ndaj klienteve per shitjen e sherbimeve si dhe tepricat debitore te marrdhenieve me furnitoret.

Shumat e paraqitura ne "Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme" perfaqesojne kërkesa debitore per:

- Kerkese Shteti- tatimin mbi fitimin.....1.825.079 leke
- Kerkesa te tjera debitore(furnitotre debitore).....10.729617 leke

Ne zerin" Instrumente të tjera borxhi" jane paraqitur:

- Kerkesa te tjera debitore-Hua te perkoshme te dhena.....20.002.370 leke

Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

5. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

| Gjendjet dhe levizjet | Toka | Ndertesa | Makineri dhe paisje | Aktivet te tjera afatgjata materiale | Totali |
|---------------------------------------|----------|----------|------------------------|--------------------------------------------|-------------------|
| A Kosto e AAM-ve me 01.01.201. | - | - | 6,868,388 | 5,212,421 | 12,080,809 |
| Shtesat | - | - | - | 445,779 | 445,779 |
| Pakesimet | - | - | - | - | - |
| Kosto e AAM-ve 31.12.2014 | - | - | 6,868,388 | 5,658,200 | 12,526,588 |
| B Amortizimi AAM-ve 01.01.2014 | - | - | 3,665,676 | 4,119,396 | 7,785,072 |
| Amortizimi ushtrimit | - | - | 640,542 | 269,957 | 910,499 |
| Amortizimi per daljet e AAM-ve | - | - | - | - | - |
| Amortizimi i AAM-ve 31.12.2014 | - | - | 4,306,218 | 4,389,353 | 8,695,571 |
| C Zhvleresimi AAM-ve 01.01.201. | - | - | - | - | - |
| Shtesat | - | - | - | - | - |
| Pakesimet | - | - | - | - | - |
| Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2014 | - | - | - | - | - |
| D Vlera neto e AAM-ve 01.01.201 | - | - | 3,202,712 | 1,093,025 | 4,295,737 |
| Vlera neto e AAM-ve 31.12.2014 | - | - | 2,562,170 | 1,268,847 | 3,831,017 |

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston(SKK-5).Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2014.

Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura jane njejta me ato qe jane perdorur ne vitet e mepershme.(shih shenimin nr.2).Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale.

6. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2013 paraqiten si vijon:

| | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014 | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013 |
|----------------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|
| Huatë dhe parapagimet | | |
| (i) Të pagueshme ndaj furnitorëve | | 0 |
| (ii) Të pagueshme ndaj punonjësve | 1,120,612 | 1,117,618 |
| (iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqerore | 765,787 | 406,631 |
| (iv) Hua të tjera | | 726,818 |
| (v) Parapagimet e arkëtuara | 0 | 0 |
| Shuma | 1,886,399 | 2,251,067 |

Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujtuar ne fund te ushtrimit..Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

"Të pagueshme ndaj punonjësve" perbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit ne 31.12.2014.

"Detyrimet tatimore+sig.shoqerore" perbehen nga:

- Shteti-tatimi mbi vleren e shtuar.....566.514 leke
- Sigurime shoqerore e shendetesore.....159.883 leke
- Tatim mbi te ardhurat personale(TAP).....39.390 leke

7. Kapitalet e veta

Kapitali i regjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Me 31.12. 2013 kapitali i regjistruar eshte 110.000 leke,dhe per efekt te sistemit elektronik te QKR-se eshte i ndare ne 100 kuota me vlere nominale 1.100 leke /kuota. Kapitali regjistruar zoterohet perkatesisht nga ortaku Faruk Kaba me kuoten 98 % dhe ortakja Teuta Kaba me kuoten 2% te kapitalit. Gjate ushtrimit kontabel 2014 nuk ka rritje ose pakesim ne kapitalin e regjistruar te shoqerise. Me vendim te asamblese se ortakeve fitimet e vitit 2013 jane destinuar per dividend ne shumen 15.000.000 leke dhe pjesa tjeter ne rezervat e kapitalit.

8. Fitimi (humbja) e vitit financiar-Te ardhurat dhe shpenzimet

▪ Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

| | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014 | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013 |
|--------------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|
| Te ardhurat | | |
| Te ardhurat nga shitja e produkteve | 0 | 0 |
| Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve | 64,329,973 | 55,140,212 |
| Te ardhurat nga shitja e mallrave | 0 | |
| Te ardhurat te tjera(AAM,etj) | 0 | 0 |
| Shuma | 64,329,973 | 55,140,212 |

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të zhveshura nga TVSH-ja. Paraqitja në pasqyrat financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve është bërë sipas natyrës së tyre.

▪ **Shpenzimet e veprimtarisë kryesore**

Sipas natyrës së tyre shpenzimet e ushtrimit 2014 janë treguar në pasqyrën përkatëse të PASH-së. Materialet dhe mallrat e konsumuara, pagat e personelit, shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe amortizimet e zhvlerësimet e AAM-ve, dhe shpenzimet e tjera janë pasqyruar me shumën e paguara ose të pagueshme. Analiza e disa prej këtyre zerave jepet në vijim.

▪ **Shpenzime personeli**

Numri mesatar i punonjësve dhe pagat sipas kategoritë kryesore janë si më poshtë :

| Kategoritë | Ushtrimi 2014 (000 leke) | | | Ushtrimi 2013 (000 leke) | | |
|---------------------------------|--------------------------|--------------|----------------------|--------------------------|--------------|----------------------|
| | Numer mesatar | Paga | Sigurime punedhenesi | Numer mesatar | Paga | Sigurime punedhenesi |
| Administrator, menaxher | 1 | 1,800 | 149 | 1 | 1,800 | 149 |
| Specialist me arsim universitar | 8 | 4,091 | 813 | 11 | 6,917 | 923 |
| Teknike | - | - | - | - | - | - |
| Puntor | 3 | 792 | 132 | 2 | 408 | 68 |
| Shuma | 12 | 6,683 | 1,095 | 14 | 9,125 | 1,140 |

Në shpenzimet për personelin, janë përfshirë shpenzimet për paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore e shëndetësore të llogaritura gjatë vitit 2014. Detyrimet që lindin për tatimin mbi pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punonjësit, janë llogaritur, deklaruar dhe paguar në përputhje me kërkesat ligjore.

▪ **Shpenzime të tjera**

Zeri "Shpenzime të tjera" pasqyruar në pikën 7 të PASH analizohet si vijon:

| | Viti raportues 31.12.2014 | Viti paraardhës 31.12.2013 |
|---------------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Shpenzime të tjera | | |
| Telefoni, internet | 23,670 | 584,750 |
| Qera | 1,200,000 | 1,080,000 |
| Sherbime nga të tretet | 19,516,550 | 6,961,273 |
| Të tjera shërbime | 122,064 | 819,000 |
| Tatime, taksa dhe derdhje të ngjashme | 1,119,245 | 775,690 |
| Shpenzime të tjera rrjedhese | 14,020 | - |
| Shuma | 21,995,549 | 10,220,713 |

▪ **Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Janë paraqitur si diferencë e të ardhurave me shpenzimet sipas kërkesave të standarteve.

9. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2014 dhe 2013 jane si vijon:

| | Viti raportues 31.12.2014 | Viti paraardhës 31.12.2013 |
|-------------------------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| I FITIMI NETO PARA TATIMIT | 32,711,671 | 32,169,611 |
| II SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+) | 1,087,998 | 1,211,241 |
| 1 Amortizime tej normave fiskale | - | - |
| 2 Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor | - | - |
| 3 Gjoha,penalitete,demshperblime | 1,087,998 | 10,000 |
| 4 Provizione qe nuk njihen | - | - |
| 5 Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta | - | - |
| 6 Te tjera | - | 1,201,241 |
| III PJESA E HUMBES SE MBARTUR(-) | - | - |
| III.1 Divident nga pjesmarrjet rezidente(-) | - | - |
| IV FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III) | 33,799,669 | 33,380,852 |
| V Shpenzimi i tatim fitimit-10% | 5,069,950 | 3,338,085 |
| VI FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V) | 27,641,721 | 28,831,526 |

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme.

10. Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksione dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre , nuk ka te tjera me palet e lidhura.

11. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare. Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare te shoqerise, rezulton se ne ushtrimin 2014 eshte rritur shifra e afarizmit dhe rezultati financiar..

Shifrat krahasuese

Shifrat krahasuese te deklaruar ne pasqyrat financiare 2013 jane te njejta me ato te prezantuara ne vitin aktual 2014.